



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI**

VENDIM

Nr. 98/2017

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT “PËR DIASPORËN DHE MIGRACIONIN”, NË PËRBËRJE
TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR
PËR POLITIKËN E JASHTME**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:**

I. Ngrihet nënkomisioni “Për diasporën dhe migracionin”, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Politikën e Jashtme.

II. Objekti dhe fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni janë çështje të diasporës dhe fenomenit migrator të Shqipërisë.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë:

1. Adnor Shameti Kryetar (PS)
2. Tritan Shehu Zëvendëskryetar (PD)
3. Elona Hoxha Anëtare (PS)
4. Eglantina Gjermeni Anëtare(PS)
5. Klajda Gjoshja Anëtare (LSI)

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 5.10.2017